

VENDIM
Nr.595, datë 1.10.2007

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TELE JONI”
SUBJEKTIT: “TELE JONI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “TELE JONI” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën Himarë-Sarandë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)